



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

**Lindita NIKOLLA**

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2022**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

**Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2022 në drejtim të:**

Testimit në vazhdimësi të kapaciteteve, aftësisë paguese dhe nivelin e gatishmërisë për të përshpejtuar procesin e kompensimit të depozitave në rastin e ndodhjes së një ngjarje sigurimi;

Hartimit të marrëveshjes ndërmjet Agjencisë dhe Bankës së Shqipërisë, që do t'i mundësojë Agjencisë një qasje të shpejtë në fonde të nevojshme për përmbushjen e mandatit të saj ligjor për kompensimin e depozitave të siguruara;

Përmirësimin të kuadrit nënligjor në drejtim të përputhshmërisë së kuadrit rregullativ shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian për sigurimin e depozitave;

Kontributin të dhënë në funksion të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e subjekteve që ofrojnë shërbime financiare.

**Kuvendi rekomandon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për vitin 2023 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

1. Të bashkëpunojë me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave për kryerjen e simulimeve teknike në funksion të gatishmërisë së tyre në lidhje me mbajtjen dhe raportimin e të dhënave të depozituesve të siguruar, sipas kriterëve të përcaktuara nga Agjencia.

2. Të vijojë bashkëpunimin me bankat agjente të përzgjedhura nëpërmjet simulimit të një ngjarje sigurimi, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e sistemeve të bankave agjente dhe të Agjencisë për të realizuar me sukses një ngjarje sigurimi.

3. Të kujdeset për sigurimin e kapaciteteve mbështetëse, të nevojshme në rast ngjarje sigurimi, me qëllim rritjen e gatishmërisë operationale dhe teknike për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit.

4. Të diversifikojë mjetet e komunikimit për të rritur nivelin e informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave.

5. Të vijojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar në vend dhe në funksion të procesit të integritetit evropian.

Miraturar në datën 8.6.2023